(1)

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL**

Nr. 3055 Prot Elbasan më 17/06/2025

**RELACION**

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë pë muajin MAJ 2025**

KËSHILLIT BASHKIAK

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 23 datë 04.03.2025 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"

**Propozojmë:**

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin MAJ 2025 gjithsej 73 familje me një fond gjithsej 214.440 lekë .
   Këto janë familje shumë të varfëra të cilat nuk kanë mundësi të aplikojnë në sistemin e ndihmës ekonomike pasi për shkaqe të ndryshme sociale, shëndetësore dhe ekonomike, një anëtar madhor nuk është prezent gjatë aplikimit .
   Këto janë raste të grave të braktisura nga bashkëshortët e tyre dhe anasjelltas, familje të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të shëndetit mendor të cilët largohen nga banesa pa adresë fikse, familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të ndryshme sociale (alkooli, droga etj) të cilët nuk janë në gjendje të paraqiten në ditën e aplikimit të ndihmës ekonomike në sistem.

2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: M.Duka
Pranoi: D.Shuli
Konfirmoi: D.Rroseni

**Zv/Kryetari**

**Armand Shehu**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr_______Prot                                        Elbasan më____/06/ 2025

**PROJEKT - VENDIM**

Nr. _____ datë____/06/ 2025

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin MAJ 2025**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/06/2025 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DSHKSK, bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", V.K.M nr. 597,datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 23 datë 04.03.2025 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"

**VENDOSI**

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin MAJ 2025 për 73 familje me një fond prej 214.440 lekë.
2 Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3 Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4 Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr Shërbimeve Sociale D.Shuli
Drejtori Juridik A.Hoxha                    Drejtori Finance-Buxhet A. Merkja

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**
**Sokol Sinani**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**
**Lutfi Lala**

**Adresa:** *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIAL
SEKTORI I VLERËSIMIT DHE PAGESAVE TË NDIHMËS EKONOMIKE
DHE AFTËSISË SË KUFIZUAR

**INFORMACION KRAHASUES PËR NDIHMËN EKONOMIKE PËR MUAJIN MAJ 2025**

## I. Ndihma ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Maj 2025

| | | | |
|---|---|---|---|
| Maj | 257 familje | fondi | 1.221.389 |
| Prill | 231 familje | fondi | 1.101.172 |

Për muajin Maj 2025 kemi 26 familje me shume se muaji paraardhes që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi I kushtëzuar.

Fondi i shpenzuar është 120.217 lekë më shume se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I kushtëzuar janë:

1. Asim Beti (aplikon ne sistem)
2. Brunilda Çullhaj (aplikon ne sistem)
3. Vera Tarami (aplikon ne sistem)
4. Mira Senja (aplikon ne sistem)
5. Sonila Kroj (aplikon ne sistem)
6. Redon Karaj (nuk paraqitet)
7. Klodian Blloshmi (nuk paraqitet)
8. Indrit Muça (nuk paraqitet)
9. Manjola Prifti (nuk paraqitet)

## II. Ndihma ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Maj 2025

| | | | |
|---|---|---|---|
| Maj | 73 familje | fondi | 214.440 |
| Prill | 75 familje | fondi | 214.600 |

Për muajin Maj 2025 kemi 2 familje më pak se muaji paraardhes që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Bashkisë.

Fondi është 160 lekë më pak se muaji paraardhës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr.Prot 3054 Elbasan më 17/06/2025

**RELACION**

**Mbi dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin MAJ 2025**

**KËSHILLIT BASHKIAK**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 24 datë 04.03.2025 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike", paraqesim per miratim propozimin e familjeve qe do trajtohen nga fondi i kushtezuar.

**I.** Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin MAJ 2025 , **257 familje** me një fond prej **1.221.389 lekë**.

Këto janë familje të varfra të cilat kanë aplikuar në sistemin e ndihmës ekonomike dhe për shkak se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme, nuk janë kualifikuar përfitues të ndihmës ekonomike nga sistemi i pikëzimit.

Këto janë kryesisht familje me një ose dy antarë. Pra këtu kemi familje të cilat janë me një anëtarë, si femrat ose meshkujt në moshë të madhe të pamartuar ose të divorcuar, të cilët kanë ose jo një ose dy fëmijë në ngarkim ; personat mbi moshë pune të cilët nuk kanë përfituar pension pleqërie .

Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: M.Duka
Pranoi: D.Shuli
Miratoi: D.Rroseni

**ZV/KRYETARI**

**ARMAND SHEHU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr_______Prot                                                    Elbasan më____/06/ 2025

**PROJEKT – VENDIM**

Nr. ____ datë ____/06/2025

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin MAJ 2025**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____06/2025 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DPPSSSHKI, bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 24 datë 04.03.2025 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike"

**VENDOSI**

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin MAJ 2025 për 257 familje me një fond prej **1.221.389** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtori Sherbimit Social D.Shuli
Drejtori Juridik A.Hoxha                    Drejtori Finance-Buxhet A. Merkja

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**                    **Kryetar i Këshillit Bashkiak**

**Sokol Sinani**                    **Lutfi Lala**

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. ______ Prot. Datë _____ .06. 2025

**P/VENDIM**

**NR. ______, DATË ______. 06. 2025**

**MBI**

**"MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028, FAZA E PARË"**

Këshilli Bashkiak i Qytetit Elbasan, i mbledhur sot më datë ____ .06.2025, pasi mori në shqyrtim materialet e përgatitura nga Bashkia e Qytetit Elbasan, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, "Mbi miratimin e fazës së parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028", mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", si dhe Udhëzimin nr.8, datë 28.02.2025 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028",

**VENDOSI :**

1. Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Elbasan, faza e parë, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETAR**
**Sokol Sinani**

**KRYETAR**
**Lutfi Lala**

P/Sekt.Buxhetit : M.Beluli
Dr.Buxhet Fin.: A.Merkja
D.P.Sh.M: S. Mehmeti
D.P.Zh.T.P.P : D.Meta
D.P.K.S.A.R.S : D.Rroseni
D.P.M.C.M.B.P : Sh. Çullhaj
Dr.Juridike: A.Hoxha
Zv/kryetar : A. Shehu
Zv/kryetar : A. Sula

**REPUBLIKA E SHQIPERISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**DREJTORIA BUXHET FINANCË**
**SEKTORI I BUXHETIT**

**Nr. 3228 Prot.**

**Elbasan më 26 .06. 2025**

**RELACION**

"Shtesë e të ardhurave të trashëguara dhe e shpenzimeve, si dhe ndryshim fonde në buxhetin e vitit 2025".

**KËSHILLIT BASHKIAK**

Të nderuar Këshilltarë !

**a)** Në zbatim të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise", i ndryshuar, ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr.115, datë 03.12.2024 "Për buxhetin e vitit 2025", me vendimin Tuaj Nr.138, datë 26.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2025, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2025-2027" dhe vendimin nr.27, datë 04.03.2025 "Ndryshim i burimit te financimit në buxhetin e vitit 2025", janë përdorur gjithsej 262,390,205 lekë nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2024, të cilat janë shpërndarë në shpenzime, kryesisht detyrime dhe kontrata nga viti 2024.

Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", përcakton miratimin e projekt buxhetit vjetor jo më vonë se data 25 dhjetor e çdo viti kalendarik. Në këto kushte, meqenëse veprimet financiare për llogari të vitit ushtrimor vazhdojnë deri më 31 dhjetor, në buxhetin e vitit 2025, të ardhurat e trashëguara dhe shpenzimet e mbartura nga viti 2024 u parashikuan në mënyrë të përafërt.

Në mbyllje të vitit 2024, pas rakordimeve dhe konfirmimit nga Dega e Thesarit, totali i të ardhurave që trashëgohen për Bashkinë Elbasan rezulton në shumën 401,172,609.50 lekë, kundrejt 262,390,2025 lekë të miratuara deri më sot në buxhetin e vitit 2025, me vendimet tuaja të sipërpërmëdur, ose 138,782,404.50 lekë më shumë se planifikimi në buxhet.

Këto të ardhura të trashëguara përbëhen nga :

| | |
|---|---|
| 85,722,118.00 | grant specifik (transfertë sektoriale) |
| 21,539,789.90 | grant i pakushtëzuar |
| 4,341,408.65 | trashëguar institucionet nga të ardhurat e veta |
| 27,179,087.95 | teprica të ardhura nga situcionet + akt rakordimi Bashkia. |
| **138,782,404.50** | **lekë gjithsej.** |

Gjithashtu, referuar shkresës së Ministrisë së Financave, nr.17266, datë 17.12.2024, protokolluar nga Bashkia Elbasan me nr.7006, datë 23.12.2024, për Bashkinë Elbasan rezulton shtesë e fondeve grant (transfertë e pakushtëzuar sektoriale) për vitin 2025, për funksionin "menaxhimi i mbetjeve urbane", krahasuar me fondin e miratuar. Më konkretisht, referuar shkresës së Ministrisë së Financave nr.14488, datë 29.10.2024 "Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2025", fondi për "menaxhimin e mbetjeve urbane" është 18,993,000 lekë, fond të cilin e kemi miratuar në buxhetin e vitit 2025, me vendimin tuaj nr.138, datë 26.12.2024. Mbas miratimit të buxhetit për vitin 2025, referuar shkresës së Ministrisë së Financave, nr.17266, datë 17.12.2024, prot.nga Bashkia Elbasan me nr.7006, datë 23.12.2024, (për të cilën kemi marrë njoftim në fund të vitit 2024) fondi për menaxhimin e mbetjeve urbane është 28,927,711 lekë, ose 9,934,711 lekë me shumë se fondi i miratuar në buxhetin e vitit 2025.
Në këto kushte është detyrim miratimi i diferencës së fondeve, grant specifik për "menaxhimin e mbetjeve urbane". Meqenëse nga ky shërbim janë trashëguar detyrime nga viti i kaluar, kjo diferencë e fondeve do të përdoret për këtë qëllim.

***Në total, shuma e trashëguar nga viti 2024, plus diferencën e grantit specifik 2025 ardhur për menaxhimin e mbetjeve urbane, është : 148,717,115.50 lekë*** *(138,782,404.50 + 9,934,711).*

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", që buxheti të jetë i balancuar është e domosdoshme rritja e buxhetit të vitit 2025 me **148,717,115.50** lekë të ardhura të trashëguara nga viti 2024 dhe shtesë fonde grant specifik të vitit 2025, si dhe nga ana tjetër, me lekë **148,717,115.50** shpenzime.

Në tabelën nr.1, 2 3 dhe 4 do të gjeni detajimin e shpenzimeve sipas burimit të fondeve, ku pjesa më e madhe do të përdoren për të financuar detyrimet që u mbartën nga viti 2024, të cilat nuk u kaluan në muajin dhjetor për arsye të kohës së limituar për përgatitjen e dokumentacioneve, si dhe raste shpenzimesh të rishikuara për vitin 2025.
Në detajimin e grantit specifik të trashëguar është ruajtur destinacioni dhe fondet janë shpërndarë sipas burimit të fondit të trashëguar, për çdo njësi shpenzuese.
Gjithashtu, në këtë material do të trajtohen edhe shpenzimet për investime të pa likujduara në vitin 2024 (tab.nr.5).

Bazuar në shkresën nr.130, datë 20.05.2025 të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit, për nevojat e konvikteve është parashikuar blerja e një mjeti tip kamionçinë, financuar me fondet e trashëguara nga transferta sektoriale për konviktet.
Në tabelat bashkëngjitur këtij relacioni, Ju keni një informacion më të detajuar në lidhje me shpenzimet sipas njësive shpenzuese, llojit të shpenzimeve, si dhe të investimeve në objekte.

b) Gjatë prokurimit të fondeve për vitin 2025, rezultojnë një numër objektesh me teprica prokurimi në vlera të konsiderueshme. Gjithashtu, nga rishikimi i fondeve për pagat dhe sigurimet rezultojnë teprica fondesh si rezultat e vendeve vakant gjatë kohës së ristrukturimit të administratës së Bashkisë dhe të institucioneve vartëse. Për menaxhimin sa më të mirë të burimeve dhe detyrimeve, propozojmë që tepricat e fondeve nga prokurimet si dhe fondet e lira të pagave dhe të shpenzimeve në buxhetin e vitit 2025, të transferohen për financimin e detyrimeve të krijuara nga shpenzimet e muajit të fundit të vitit 2024, si më poshte :

**Paksohet :**

| | *në lekë* |
|---|---|
| 1. "Rivitalizim urban i rrotondës tek kryqëzimi "Luleve", rrotondës "1 Maji", rrotondës "Postës" dhe rrotondës tek "Bashkia " *(tepricë prok.)*, instituc.ASHPU | 1,300,000 |
| 2. "Rivitalizimi urban i shesheve publike te pallateve 588,712, etj.(Aleks Buda), në lagjen "5 Maji" *(tepricë prokurimi)*, institucioni ASHPU; | 13,100,000 |
| 3. "Mobilimi i sallës së Këshillit, salëes multifunksionale dhe të shërbimeve ndaj qytetarëve" *(tepricë prokurimi)*, institucioni Bashkia; | 2,600,000 |
| 4. "Veshje me beton e kanaleve ujitëse I dhe II, në njësitë administrative" *(tepricë prokurimi )*, institucioni ASHPR; | 4,815,000 |
| 5. Shpenzime paga Bashkia, Funksioni 01110, artikulli 600, | 7,000,000 |
| 6. Shpenzime paga Agj.Shërb. Sociale , Funksioni 10430, artikulli 600, | 4,000,000 |
| 7. Shpenzime interesa huaja, inst.Bashkia, Funksioni 01710 , artikulli 651, | 2,000,000 |
| 8. Shpenzime principal huaja, inst.Bashkia, Funksioni 01710 , artikulli 166, | 2,000,000 |
| **Gjithsej :** | **36,815,000** |

**Shtohet :**

| | *në lekë* |
|---|---|
| 1. Produkti V510AAB, artikulli 602, shërbimi i pastrimit, instituc. Bashkia | 11,570,000 |
| 2. Produkti V626AAF, artikulli 602, shërbim kamera, instituc. ASHPU | 3,579,000 |
| 3. Produkti V626AAF, artikulli 602, shërbimi i rojeve, instituc. ASHPU | 17,179,000 |
| 4. Produkti V626AAC, artikulli 602, mirëmbajtje rrugë, instituc. ASHPU | 1,800,000 |
| 5. Produkti V626AAG, artikulli 602, mirëmbajtje trotuare instituc. ASHPU | 2,687,000 |
| **Gjithsej :** | **36,815,000** |

c) Nëpermjet shkresës nr.201/1, datë 29.04.2025 "Kërkesë për ndryshim planifikimi", Agjencia e Mbikqyrjes dhe Kontrollit kërkon që nga buxheti i miratuar për shpenzime për vitin 2025, të transferojë një pjesë të fondeve, nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit në Drejtorinë e Taksave, Tarifave Vendore dhe Tregjeve për blerje shtypshkrime pasi nuk ka të miratuar në buxhet fonde për këtë qëllim. Meqenëse kemi të bëjmë me dy programe të ndyshme, kërkojmë miratimin Tuaj për transferimin e shpenzimeve në Agjencinë e Mbikqyrjes dhe Kontrollit, si më poshtë :

**Paksohet ;**

Programi AE109, Funksioni 06140, artikulli 602, "Kancelari dhe bojra" IMT, 290,000 lekë.

**Shtohet :**

Programi AA109, Funksioni 01120, artikulli 602, "Blerje shtypshkrime" DTTVT, 290,000 lekë.

*Për sa më sipër, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", udhëzimin nr.2, datë 24.01.2025 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025" dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.138, datë 26.12.2024 "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2025, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2025-2027", i ndryshuar, Ju propozojmë të miratoni këtë material, në mënyrë që të ruhet balanca në buxhet.*

***Duke ju falënderuar për bashkëpunimin !***

Koncep. P/Sekt. Buxhetit : M. Beluli

Dr.Buxhet Finance : A.Merkja

Dr.Përgjithshëm : S. Mehmeti

**ZV/KRYETARI**
**Asim Sula**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

**Adresa: Bashkia Elbasan, Rr "Qemal Stafa",Tel. +355 54 400152,E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al**

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _______ Prot. Datë ____.06. 2025

P/VENDIM

NR. ______ DATE _____. 06. 2025

MBI
"SHTESË E TË ARDHURAVE TË TRASHËGUARA DHE E SHPENZIMEVE, SI DHE NDRYSHIM FONDE NË BUXHETIN E VITIT 2025"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin nr.115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", Udhëzimin plotësues nr.2, datë 24.01.2025 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025" dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.138, datë 26.12.2024, për "Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2025, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027", i ndryshuar, pasi mori në shqyrtim materialet mbi "Shtesë e të ardhurave të trashëguara dhe e shpenzimeve, si dhe ndryshim fonde në buxhetin e vitit 2025", përgatitur nga administrata e Bashkisë Elbasan,

VENDOSI

1. Të miratojë rritjen e të ardhurave të trashëguara dhe të shpenzimeve, pjesë e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2025, si më poshtë dhe sipas pasqyrave bashkëlidhur :

   **A.** Të ardhura gjithsej: **138,782,404.50 lekë**

   **B.** Shpenzime gjithsej : **138,782,404.50 lekë**

2. Të miratoje detajimin e shtesës së fondeve grant për vitin 2025, transfertë specifike sektoriale për "menaxhimin e mbetjeve urbane", për shumën 9,934,711 lekë (tab. nr.4, bashkëlidhur).

3. Në buxhetin e vitit 2025, të bëhen ndyshimet për financimin e shpenzimeve të krijuara në fund të vitit 2024, si më poshtë :

| **Paksohet :** | *në lekë* |
|---|---|
| - "Rivitalizim urban i rrotondës tek kryqëzimi "Luleve", rrotondës "1 Maji", rrotondës "Postës" dhe rrotondës tek "Bashkia " *(tepricë prok.)*, ASHPU | 1,300,000 |
| - "Rivitalizimi urban i sheshеve publike të pallatve 588,712, etj.(AleksBuda), në lagjen "5 Maji" *(tepricë prokurimi),* institucioni ASHPU; | 13,100,000 |

- "Mobilimi i sallës së Këshillit, salëes multifunksionale dhe të shërbimeve ndaj qytetarëve" *(tepricë prokurimi),* institucioni Bashkia; 2,600,000
- "Veshje me beton e kanaleve ujitëse I dhe II, në njësitë administrative" *(tepricë prokurimi ),* institucioni ASHPR; 4,815,000
- Shpenzime paga Bashkia, Funksioni 01110, artikulli 600 (paga), 7,000,000
- Shpenzime paga Agj.Shërb. Sociale , Funksioni 10430, artikulli 600 (paga), 4,000,000
- Shpenzime interesa huaja, inst.Bashkia, Funksioni 01710 , artikulli 651, 2,000,000
- Shpenzime principal huaja, inst.Bashkia, Funksioni 01710 , artikulli 166, 2,000,000

**Gjithsej : 36,815,000**

**Shtohet :**

***në lekë***

- Produkti V510AAB, artikulli 602, shërbimi i pastrimit, instituc. Bashkia 11,570,000
- Produkti V626AAF, artikulli 602, shërbim kamera, instituc. ASHPU 3,579,000
- Produkti V626AAF, artikulli 602, shërbimi i rojeve, instituc. ASHPU 17,179,000
- Produkti V626AAC, artikulli 602, mirëmbajtje rrugë, instituc. ASHPU 1,800,000
- Produkti V626AAG, artikulli 602, mirëmbajtje trotuare instituc. ASHPU 2,687,000

**Gjithsej : 36,815,000**

**4.** Në buxhetin e miratuar për vitin 2025, për Agjecinë e Mbikqyrjes dhe Kontrollit, të bëhen ndryshimet si më poshtë :

**Paksohet ;**

Programi AE109, Funksioni 06140, artikulli 602, "Kancelari dhe bojra" IMT, 290,000 lekë.

**Shtohet :**

Programi AA109, Funksioni 01120, artikulli 602, "Blerje shtypshkrime" DTTVT, 290,000 lekë.

**5.** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Buxhet Financë (Sektori i Buxhetit) dhe njësitë shpenzuese.

**6.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

**SEKRETAR**
**Sokol Sinani**

**KRYETAR**
**Lutfi Lala**

P/Sekt.Buxhetit : M.Beluli

Dr.Buxhet Financë : A.Merkja

Dr.Juridike: A.Hoxha

Zv/kryetar : A. Sula

BASHKIA E QYTETIT ELBASAN

BUXHETI I VITIT 2025

Tabela Nr.1

## SHPENZIME SHTESE NGA GRANTI I TRASHEGUAR NGA VITI 2024

ne leke

| | Gr | Programi | Funksion | Produkti | Kap | Emertimi | Institucioni | kodi insitucionit | SHPENZIMET VITI 2025 600 | 601 | 602 | 606 | 231 | TOTAL |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Totali : | | | **0** | **0** | **372,905.90** | **1,077,000** | **1,623,364** | **3,073,269.90** |
| 1 | 00 | AA109 | 01110 | V111AAA | 1 | Planifikim, menaxhim & admin. | **Bashkia** | 2109001 | | | | | | 0.00 |
| | 00 | AA109 | 01110 | V111AAD | 1 | Planifikim, menaxhim & administrim | **Bashkia** | 2109001 | | | 372,905.90 | | | 372,905.90 |
| | 00 | AC109 | 04240 | V424AAB | 1 | Ujitja dhe Kullimi | **Bashkia** | 2109001 | | | | | 4,200 | 4,200.00 |
| | 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 1 | Infrastruktura Rrugore | **Bashkia** | 2109001 | | | | | 615,388 | 615,388.00 |
| | 00 | AD109 | 05100 | V510AAB | 1 | Menaxhimi I mbetjeve | **Bashkia** | 2109001 | | | | | 33,000 | 33,000.00 |
| | 00 | AD109 | 05200 | V520AAF | 1 | KUZ | **Bashkia** | 2109001 | | | | | 45,000 | 45,000.00 |
| | 00 | AG109 | 09120 | V912AAK | 1 | Arsimi baze | **Bashkia** | 2109001 | | | | | 795,040 | 795,040.00 |
| | 00 | AH109 | 10430 | P043AAN | 4 | Projekt I huaj (bashkefinancim) | **Bashkia** | 2109001 | | | | | 130,736 | 130,736.00 |
| | 00 | AH109 | 10661 | V066AAB | 1 | Bonus strehimi | **Bashkia** | 2109001 | | | | 1,077,000 | | 1,077,000.00 |
| | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | Totali : | | | **0** | **0** | **8,067,000** | **0** | **1,500** | **8,068,500.00** |
| 2 | 00 | AG109 | 09120 | V912AAB | 1 | Arsimi baze | **Dr.Pergj.Arsimit** | 2109008 | | | 3,152,000 | | | 3,152,000.00 |
| | 00 | AG109 | 09120 | V912AAF | 1 | Arsimi baze (Q.Kult.) | **Dr.Pergj.Arsimit** | 2109008 | | | 150,000 | | | 150,000.00 |
| | 00 | AG109 | 09120 | V912AAK | 1 | Arsimi baze | **Dr.Pergj.Arsimit** | 2109008 | | | | | 1,500 | 1,500.00 |
| | 00 | AG109 | 09230 | V923AAB | 1 | Arsimi mesem pergjith. | **Dr.Pergj.Arsimit** | 2109008 | | | 4,381,000 | | | 4,381,000.00 |
| | 00 | AH109 | 10430 | V043AAC | 1 | Perkujdesja sociale (Çerdhe) | **Dr.Pergj.Arsimit** | 2109008 | | | 384,000 | | | 384,000.00 |
| | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | Totali : | | | **0** | **0** | **2,236,000** | **0** | **0** | **2,236,000.00** |
| 3 | 00 | AF109 | 08220 | V822AAC | 1 | Trasheg. Kulturore | **D.P K.S.** | 2109012 | | | | | | 0.00 |
| | 00 | AF109 | 08230 | V823AAB | 1 | Arti dhe kultura | **D.P K.S.** | 2109012 | | | 2,236,000 | | | 2,236,000.00 |
| | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | Totali : | | | **0** | **0** | **2,731,000** | **0** | **10,431,020** | **13,162,020.00** |
| 4 | 00 | AC109 | 04240 | V424AAB | 1 | Ujitja dhe Kullimi | **ASHPR** | 2109014 | | | 1,000,000 | | | 1,000,000.00 |
| | 00 | AC109 | 04520 | V452AAB | 1 | Infrastruktura rrugore | **ASHPR** | 2109014 | | | 1,695,000 | | | 1,695,000.00 |
| | 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 1 | Infrastruktura rrugore | **ASHPR** | 2109014 | | | | | 10,016,300 | 10,016,300.00 |
| | 00 | AE109 | 06260 | V626AAF | 1 | Sherb.Publike (mekanik & miremb.) | **ASHPR** | 2109014 | | | 36,000 | | | 36,000.00 |
| | 00 | AE109 | 06440 | V644AAC | 1 | Ndricim rrugur rural | **ASHPR** | 2109014 | | | | | 414,720 | 414,720.00 |
| | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | **TOTALI :** | | | **0** | **0** | **13,406,905.90** | **1,077,000** | **12,055,884** | **26,539,789.90** |

BASHKIA E QYTETIT ELBASAN

BUXHETI I VITIT 2025

Tabela Nr.2

SHPENZIME SHTESE NGA GRANTI SPECIFIK I TRASHEGUAR NGA VITI 2024

ne leke

| | | | | | | | | SHPENZIMET VITI 2025 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gr | Programi | Funksion | Produkti | Kap | Institucioni | kodi insitucionit | 600 | 601 | 602 | 606 | 231 | TOTAL |
| 1 | 00 | AB109 | 03280 | V328AAA | 1 | AMK (Sherbimi mbrojtjes nga zjarri) | 2109026 | | | 675,000 | | | 675,000.00 |
| 2 | 00 | AG109 | 09120 | V912AAA | 1 | Dr.Pergj.Arsimit (ars.parashkollor) | 2109008 | 60,900,000 | 10,080,597 | | | | 70,980,597.00 |
| | 00 | AG109 | 09230 | V923AAA | 1 | Dr.Pergj.Arsimit (pun.sherb.ars.mese | 2109008 | | | | | | 0.00 |
| | 00 | AG109 | 09230 | V923AAA | 1 | Dr.Pergj.Arsimit (konviktet) | 2109008 | 3,200,000 | 537,248 | | | | 3,737,248.00 |
| | 00 | AG109 | 09230 | V923AAF | 1 | Dr.Pergj.Arsimit(konviktet) | 2109008 | | | 2,069,000 | | | 2,069,000.00 |
| | 00 | AG109 | 09230 | V923AAI | 1 | Dr.Pergj.Arsimit(konviktet) | 2109008 | | | | | 1,500,000 | 1,500,000.00 |
| 3 | 00 | AC109 | 04240 | V424AAB | 1 | ASHPR (Ujitja dhe Kullimi) | 2109014 | 255,865 | | 281,181 | | | 537,046.00 |
| | 00 | AC109 | 04260 | V426AAE | 1 | ASHPR (Administrimi I pyjeve dhe ku | 2109014 | 222,500 | | | | | 222,500.00 |
| | 00 | AC109 | 04520 | V452AAB | 1 | ASHPR (Rruget Rurale) | 2109014 | | | 1,000,727 | | | 1,000,727.00 |
| | | | | | | **TOTALI :** | | **64,578,365.00** | **10,617,845.00** | **4,025,908.00** | **0.00** | **1,500,000.00** | **80,722,118.00** |

BASHKIA E QYTETIT ELBASAN

BUXHETI I VITIT 2025

Tabela Nr. 3

SHPENZIME SHTESE NGA TE ARDHURAT E TRASHEGUARA NGA VITI 2024

ne leke

| | Gr | Programi | Funksioni | Produkti | Kap | Emertimi | Institucioni | kodi institucioni | SHPENZIMET VITI 2025 | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | 600 | 601 | 602 | 603 | 604 | 166 | 230 | 231 | TOTAL |
| | | | | | | Totali : | | | 0 | 0 | **15,226,616.60** | **2,444,000** | **718,000** | 0 | 0 | **111,589** | **18,500,205.60** |
| 1 | 00 | AA109 | 01110 | V111AAB | 5 | Planifikim, menaxhim & administrim | Bashkia | 2109001 | | | 720,000.00 | | | | | | 720,000.00 |
| | 00 | AA109 | 01110 | V111AAD | 5 | Planifikim, menaxhim & administrim | Bashkia | 2109001 | | | 664,616.60 | | | | | | 664,616.60 |
| | 00 | AA109 | 01110 | V111AAG | 5 | Planifikim, menaxhim & admin.(v.gjy | Bashkia | 2109001 | | | 2,055,000 | | | | | | 2,055,000.00 |
| | 00 | AA109 | 01110 | V111AAJ | 5 | Planifikim, menaxhim & admin. | Bashkia | 2109001 | | | | | 718,000 | | | | 718,000.00 |
| | 00 | AB109 | 03280 | P328AAB | 5 | Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile | Bashkia | 2109001 | | | | | | | | 111,589 | 111,589.00 |
| | 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 5 | Infrastruktura Rrugore | Bashkia | 2109001 | | | | | | | | | 0.00 |
| | 00 | AC109 | 04570 | V457AAB | 5 | Sekt.mekanik & Transporti | Bashkia | 2109001 | | | | 2,444,000 | | | | | 2,444,000.00 |
| | 00 | AD109 | 05100 | V510AAF | 5 | Menaxhimi mbetjeve | Bashkia | 2109001 | | | 787,000 | | | | | | 787,000.00 |
| | 00 | AD109 | 05100 | V510AAB | 5 | Menaxhimi I mbetjeve | Bashkia | 2109001 | | | 11,000,000 | | | | | | 11,000,000.00 |
| | | | | | | Totali : | | | 0 | 0 | **9,556,000** | 0 | 0 | 0 | 0 | **1,421** | **9,557,421.00** |
| 2 | 00 | AG109 | 09120 | V912AAA | 5 | Arsimi baze | Dr.Pergj.Arsimit | 2109008 | | | | | | | | | 0.00 |
| | 00 | AG109 | 09120 | V912AAB | 5 | Arsimi baze | Dr.Pergj.Arsimit | 2109008 | | | 2,806,000 | | | | | | 2,806,000.00 |
| | 00 | AG109 | 09120 | V912AAD | 5 | Arsimi baze (ushqime) | Dr.Pergj.Arsimit | 2109008 | | | 4,580,000 | | | | | | 4,580,000.00 |
| | 00 | AG109 | 09120 | V912AAK | 5 | Arsimi baze | Dr.Pergj. Arsimit | 2109008 | | | | | | | | 1,421 | 1,421.00 |
| | 00 | AG109 | 09230 | V923AAB | 5 | Arsimi mesem pergjith. | Dr.Pergj.Arsimit | 2109008 | | | 690,000 | | | | | | 690,000.00 |
| | 00 | AH109 | 10430 | V043AAC | 5 | Perkujdesja sociale (Çerdhe) | Dr.Pergj.Arsimit | 2109008 | | | 1,480,000 | | | | | | 1,480,000.00 |
| | | | | | | Totali : | | | 0 | 0 | **1,280,000** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **1,280,000.00** |
| 3 | 00 | AF109 | 08130 | V813AAA | 5 | Sport dhe Argetim | D.P.K.S | 2109012 | | | | | | | | | 0.00 |
| | 00 | AF109 | 08130 | V813AAB | 5 | Sport dhe Argetim | D.P.K.S | 2109012 | | | 500,000 | | | | | | 500,000.00 |
| | 00 | AF109 | 08220 | V822AAA | 5 | Trasheg. kulturore, biblioteka | D.P.K.S | 2109012 | | | | | | | | | 0.00 |
| | 00 | AF109 | 08220 | V822AAC | 5 | Trasheg. Kulturore | D.P.K.S | 2109012 | | | 480,000 | | | | | | 480,000.00 |
| | 00 | AF109 | 08230 | V823AAA | 5 | Arti dhe kultura | D.P.K.S | 2109012 | | | | | | | | | 0.00 |
| | 00 | AF109 | 08230 | V823AAB | 5 | Arti dhe kultura | D.P.K.S | 2109012 | | | 300,000 | | | | | | 300,000.00 |
| | | | | | | Totali : | | | 0 | 0 | **424,000** | | 0 | 0 | 0 | 0 | **424,000.00** |
| 4 | 00 | AD109 | 05100 | V510AAC | 5 | Menaxhimi I mbetjeve | ASHPR | 2109014 | | | 424,000 | | | | | | 424,000.00 |
| | | | | | | | | | | | | | | | | | 0.00 |
| | | | | | | Totali : | | | 0 | 0 | **1,555,000** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **1,555,000.00** |
| 5 | 00 | AE109 | 06260 | V626AAB | 5 | Mirembajtje varreza | ASHPU | 2109027 | | | 231,000 | | | | | | 231,000.00 |
| | 00 | AE109 | 06260 | V626AAH | 5 | Dekori | ASHPU | 2109027 | | | 1,324,000 | | | | | | 1,324,000.00 |
| | | | | | | Totali : | | | 0 | 0 | **100,000** | 0 | 0 | **103,870** | 0 | 0 | **203,870.00** |
| 6 | 00 | AH109 | 10430 | V043AAF | 5 | Perkujdesja sociale | Agj. Sherb.Social | 2109017 | | | 100,000 | | | | | | 100,000.00 |
| | 00 | AA109 | 01710 | V171AAB | 5 | Sherbimi I borxhit | Agj. Sherb.Social | 2109017 | | | | | | 103,870 | | | 103,870.00 |
| | | | | | | | **TOTALI :** | | **0.00** | **0.00** | **28,141,616.60** | **2,444,000.00** | **718,000.00** | **103,870.00** | **0.00** | **113,010.00** | **31,520,496.60** |

BASHKIA E QYTETIT ELBASAN

BUXHETI I VITIT 2025

Tabela Nr.4

SHPENZIME SHTESE NGA GRANTI SPECIFIK I PA SHPERNDARE PER VITIN 2025

ne leke

| | | | | | | | | SHPENZIMET VITI 2025 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gr | Programi | Funksion | Produkti | Kap | Institucioni | kodi insitucionit | 600 | 601 | 602 | 606 | 231 | TOTAL |
| | | | | | | | | | | | | | 0.00 |
| 1 | 00 | AD109 | 05100 | V510AAF | 1 | Bashkia (menaxhimi mbetjeve) | 2109001 | | | 9,934,711 | | | 9,934,711.00 |
| | | | | | | | | | | | | | 0.00 |
| | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | TOTALI : | | 0.00 | 0.00 | 9,934,711.00 | 0.00 | 0.00 | 9,934,711.00 |

BASHKIA E QYTETIT ELBASAN

BUXHETI I VITIT 2025

**Tabela Nr. 5**

**Objektet e investimeve nga te ardhurat, trasheguar nga viti 2024 (buxheti shtese )**

| Gr | Programi | Funksioni | Produkti | Kap | Art. | Institucioni | | Emertimi i objektit | Shuma leke | Burimi I finacimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 00 | AB109 | 03280 | P328AAB | 5 | 231 | **Bashkia** | 1 | Supervizim "Mbrojtja e lagjes se Noneve nga gerryerja e perroit te Gostimes, fshati Polis Vale, Nj.A.Shushice | 1,189 | te ardh.trasheg |
| 00 | AB109 | 03280 | P328AAB | 5 | 231 | **Bashkia** | 2 | Kolaudim " " " | 110,400 | te ardh.trasheg |
| | | | | | | | | **Totali programit :** | **111,589** | |
| 00 | AG109 | 09120 | V912AAK | 5 | 231 | **Q.Ek.Arsimit** | 3 | "Rikonstruksion objekte arsimore, viti 2024 (hidroizolime, riparime, etj.) | 1,421 | te ardh.trasheg |
| | | | | | | | | **Totali programit :** | **1,421** | |
| | | | | | | | | **Gjithsej investime nga te ardhurat :** | **113,010** | |

**Objektet e investimeve nga granti, trasheguar nga viti 2024 (buxheti shtese )**

| Gr | Programi | Funksioni | Produkti | Kap | Art. | Institucioni | | Emertimi i objektit | Shuma leke | Burimi I finacimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 00 | AC109 | 04240 | V424AAB | 1 | 231 | **Bashkia** | 1 | Supervizim , pastrim i kanalit kullues Vidhas( ish Komuna Paper) | 4,200 | grant. trasheg |
| | | | | | | | | **Totali programit :** | **4,200** | |
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 1 | 231 | **Bashkia** | 1 | Supervizim ndertim konstruksion rruga Shkembi i Caprazit Pajun (kont.2015, ish Komuna Paper | 30,000 | grant. trasheg |
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 1 | 231 | **Bashkia** | 2 | 5 % Garanci punimi sist.asf. rruget e brendshme Kusarth-Karakullak, 20% shtese kont. (dif 2014, ish komuna Bradashesh | 175,325 | grant. trasheg |
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 1 | 231 | **Bashkia** | 3 | Shpronesime bime arrash drufrutore (ish Komuna Bradashesh) | 125,400 | grant. trasheg |
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 1 | 231 | **Bashkia** | 4 | Supervizim "Sistemim Asfaltim rruga Rinia (diference kontrate) FZHR 2016( detyrim pjesor) | 36,000 | grant. trasheg |
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 1 | 231 | **Bashkia** | 5 | Kolaudim Sistemim Asfaltim rruga Rinia (FZHR 2016) | 160,326 | grant. trasheg |
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 1 | 231 | **Bashkia** | 6 | Shtrim pllaka trotuari sheshi i komunes Paper (detyrime ish komunat) | 50,000 | grant. trasheg |
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 1 | 231 | **Bashkia** | | Rivitalizim urban i qendres se Gjinarit dhe Fushekuqes ( financim, 2022-2024) | 34,564 | grant. trasheg |
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 1 | 231 | **Bashkia** | | Kolaudim " " " | 3,773 | grant. trasheg |
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 1 | 231 | **ASHPR** | 7 | Kolaudim " Vendosje semafore tek Kryqezimi ALPHA BANK( me rrugen" Q.Stafa"), detyrim I prapambetur | 14,000 | grant. trasheg |
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 1 | 231 | **ASHPR** | 8 | Kolaudim "Rikonstruksion ura Polis Vale" | 2,300 | grant. trasheg |
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 1 | 231 | **ASHPR** | 9 | Rikonstruksion dhe riasfaltim i gjendjes ekzistuese te rrugeve dhe shesheve ne Bashkine Elbasan (lagj.Haxhias, lagj, Clir | 10,000,000 | grant. trasheg |
| | | | | | | | | **Totali programit :** | **10,631,688** | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 00 | AD109 | 05100 | V510AAB | 1 | 231 | **Bashkia** | 1 | Supervizim "Pastrim nga mbetjet urbane perrroi i Kushes"(dif.2014, ish komuna Bradashesh). | 33,000 | grant. trasheg |
| 00 | AD109 | 05200 | V520AAF | 1 | 231 | **Bashkia** | 2 | Supervizim ndertim KUZ 4 rruget "A.Mezini", "P.Dodbiba", "Q.Fejzo", "Sh.Thanasi" ( viti 2015) | 45,000 | grant. trasheg |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | **Totali programit :** | **78,000** | |
| | | | | | | | | | | |
| 00 | AE109 | 06440 | V644AAC | 1 | 231 | **ASHPR** | 1 | Blerje shtylla xingato H=7m me 1 krahD=160mm (kontrate viti 2018) | 414,720 | grant. trasheg |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | **Totali programit :** | **414,720** | |
| | | | | | | | | | | |
| 00 | AG109 | 09120 | V912AAK | 1 | 231 | **Bashkia** | 1 | Supervizim ndertim 4 Mjedise Sportive (kontrata baze) | 40,000 | grant. trasheg |
| 00 | AG109 | 09120 | V912AAK | 1 | 231 | **Bashkia** | 2 | Supervizim ndertim shkolla 9-vjecare Paper Sollak ( ish Komuna Paper) | 14,880 | grant. trasheg |
| 00 | AG109 | 09120 | V912AAK | 1 | 231 | **Bashkia** | 3 | Supervizim Ndertim shkolle e re 9 vjecare "Xhaferr Hakani" NSHU (dif kontrate 2006) | 740,160 | grant. trasheg |
| 00 | AG109 | 09120 | V912AAK | 1 | 231 | **Dr.Pergj.Arsim** | 4 | Kolaudim " Rikonstruksion i pjesshem i shkolles 9-vjecare Mengel " ( kontrate e trasheguar) | 1,500 | grant. trasheg |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | **Totali programit :** | **796,540** | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| 00 | AH109 | 10430 | P043AAN | 1 | 231 | **Bashkia** | 1 | Pagese TVSh, projekti: "Integrimi i Romëve dhe Egjyptianëve, nëpërmjet Edukimit dhe Punësimit", bashkef. me OSFA (dif.) | 130,736 | grant.trasheg |
| | | | | | | | | **Totali programit :** | **130,736** | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | **Gjithsej investime nga granti :** | **12,055,884** | |

## Objektet e investimeve nga granti specfik , trasheguar nga viti 2024 (buxheti shtese )

| Gr | Programi | Funksioni | Produkti | Kap | Art. | Institucioni | | Emertimi i objektit | Shuma leke | Burimi I finacimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | |
| 00 | AG109 | 09230 | V923AAI | 1 | 231 | **Dr.Pergj.Arsim** | 1 | Blerje mjeti tip kamionçine | 1,500,000 | grant. specif.trash. |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | **Gjithsej investime nga granti specifik :** | **1,500,000** | |

(7)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

Nr.3187 Prot. Elbasan më 25/06/2025

RELACION

KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK

ELBASAN

***Mbi miratimin e dokumentacioneve strategjike: Planit të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike.***

Bazuar në ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ju informojmë se me asistencën e UNDP-së institucioni ynë ka përgatitur Planin e Përshtatshmërisë ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP).

Ky dokument strategjik do të jenë një gurë themeli i identifikimit të planeve tona strategjike 2024-2030 dhe me pas të punuarit sëbashku në përthithjen e investimeve të rëndësishme për Elbasanin nëpërmjet mbështetjes së ofruar nga pushteti qëndror apo edhe nga donatorët kombëtar dhe ndërkombëtar.

Përfshirja e të gjithë aktorëve, grupeve lokale të interesit publik do të na mundësojeë rritjen e transparencës në manaxhimin e projekteve të rëndësishme strategjike për Elbasanin, në lidhje me efiçencën e energjisë edhe përshtatshmërisë për ndryshimet klimatike, duke ndjekur gjithë ciklin e manaxhimit të këtij proçesi, nga identifikimi deri tek planifikimi, zbatimi, vlerësimi dhe monitorimi i politikave me impakt pozitiv në përshtatshmërinë e ndryshimeve klimatike, për Elbasanin.

Ndodhur përballë këtij fakti shprehim sot interesin tonë institucional për t'iu bashkuar paktit të Bashkimit Evropian të Kryetarëve të Bashkisë për Klimën dhe Energjinë si një iniciativë e mbështetur nga Komisioni Evropian, e cila sot bashkon mijëra qytete lokale, që duan të sigurojnë një të ardhme më të mirë për qytetarët e tyre.

Duke iu bashkuar nismës, institucioni ynë, Bashkia Elbasan do të angazhohet vullnetarisht për zbatimin e objektivave të BE-së për klimën dhe energjinë.

Angazhimet tona institucionale na venë përpara përgjegjësive për të ndërmarrë iniciativa për klimën dhe energjinë.
Synimi i këtij pakti 2030 për klimën dhe energjinë me synimin që të arrijmë të paktën 40% më pak $CO_2$ deri në vitin 2030, kjo sipas udhëzimeve dhe standarteve që vendos Bashkimi Evropian, mision i përbashkët midis vendeve të Bashkimit Evropian dhe vendeve të Ballkanit Perendimor, të cilat shfaqin interes për t'iu bashkuar paktit të Kryetarëve, e cila më pas do të ndikojë në rritjen e efiçencës ndaj ndryshimeve klimatike, në mbështetjen e tre komponente: zbutja, përshtatja dhe varfëria e energjisë.
Sot ne shprehim vullnetin tonë institucional jo vetëm për t'u bërë pjesë e paktit të kryetarëve për klimën dhe energjinë, por edhe për të ndërmarrë iniciativa të cilat më pas do t'i ndajmë si modele sukesesi mes aktorëve, pjesë e paktit të BE-së të Kryetarëve të Bashkive për klimën dhe energjinë.
Ky plan strategjik u konsultua, **më datë 17 Shkurt 2024, ora 10:00**, në ambjentet e Bashkisë Elbasan
Gjithashtu, ju informojmë se Bashkia Elbasan nëpërmjet asistencës teknike të ofruar nga UNDP-ja sapo ka përfunduar planin e përshtatshmërisë për ndryshimet klimatike të draftuar me stafin e bashkisë dhe komisionin e Mjedisit, Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Manaxhimit të Ujrave, Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Transparencës.
Politikat inkuadruese të këtyre tre shtyllave janë: **Marrëveshja e Parisit dhe Axhenda e Qëndrueshmërisë 2030 dhe Marrëveshja e Gjelbër Evropiane**, me një sërë politikash ndërsektoriale, nga Vala e Rinovimit, Lëvizshmëria e Qëndrueshme, Qëndrueshmëria e Sistemit Ushqimor, deri te zgjidhjet dhe përshtatjet e bazuara në natyrë tranzicioni dhe ekonomi rrethore.
Për të arritur pritshmëritë tona institucionale e gjithë puna jonë e përbashket do të mbështetet tek:
(1) reduktimin e emetimeve të gazeve serë në territorin tonë administrative;
(2) rritjen e elasticitetit dhe përgatitjes për ndikimet negative të ndryshimeve klimatike;

(3) dhe trajtimi i varfërisë së energjisë, si një veprim kyç për të siguruar një tranzicion të drejtë.

Bashkangjitur, ju lutem gjeni Planin e Veprimit të Përshtatshmërisë ndaj Ndryshimeve Klimatike, proçesverbalin e konsultimit të planit me grupet e interesit publik.

I gjithë proçesi është bazuar në ligjin. nr. 146/2014 për Njoftim dhe Konsultim Publik, mbështetur edhe në nënin 17 të këtij ligji.

Së bashku me njoftimin për të bërë palë grupet e interest publik (sipas linkut: https://elbasani.gov.al/notices/njoftim-per-konsultim-publik-plan-veprimi-per-pershtatshmerine-ndaj-ndryshimeve-klimatike-mbeshtetur-nga-undp-ja/).

Bashkëpunimi me ju, dhe çdo grup interesi publik, mbetët një vlerë e shtuar për institucionin tonë.

**Ju falenderojme;**

**Konceptoi:** K.Kreka
A.Hodaj
K.Çekrezi

**Pranoi:** E.Çuni
A.Merkja
A.Canaj

**Miratoi:** Sh.Çullhaj

**KRYETARI**

**Gledian LLATJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN PROJEKTEVE DHE DONATOREVE**

Nr________prot                                                  Elbasan me . ___. 2025

KËSHILLIT BASHKIAK
ELBASAN

**PROJEKT-VENDIM**

**Nr.____, datë___/___/2025**

**Mbi miratimin në parim te dokumentit strategjik: "Planit të veprimit për Përshtatshmërinë ndaj Ndryshimeve Klimatike".**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___/____/2025, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

**VENDOSI**

1. Mbi miratimin në parim të "Planit të Veprimit për Përshtatshmërinë ndaj Ndryshimeve Klimatike»
2. Ngarkohen për zbatim drejtoritë e Bashkisë Elbasan: Drejtoria e Zhvillimit Strategjik dhe Transportit, Drejtoria e Integrimit Evropian Projekteve Strategjike Inovacionit, Drejtoria Juridike,
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

**Konceptoi: SIEPHI** **K.Kreka**
**Pranoi: Dr. DIEPSI** **E.Cuni**
**D.D.ZH.E.S.T** **A.Canaj**
**Miratoi: D.J** **A.Hoxha**

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**

**Sokol Sinanni**

**Kryetar i Këshillit Bashkiak**

**Lutfi LALA**

(8)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES CIVILE, MJEDISIT, BUJQËSISË, PYJEVE DHE KULLOTAVE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 3121 Prot. Elbasan më, 23.06.2025

# RELACION

**Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Vangjel Taqi Prifti banor në lagjen "Visarjon Xhuvani", nr. 4 dhe dhënien e kompensimit nga ana e Bashkisë Elbasan**

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Mbrojtjes Civile,

Në zbatim të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile" dhe të VKM nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", sektori përkatës pas marrjes së njoftimit verbalisht si edhe me shkresë zyrtare 694 prot. datë 28.03.2025 për djegien e banesës së **Z. Vangjel Taqi Prifti**, banor në lagjen "Visarjon Xhuvani", nr. 4, ( kërkesë e kryer nga Z. Vangjel Taqi Prifti) në datë 26.03.2025 (konfirmuar edhe nga Vërtetimi i SHMZSH nr. 07 datë 01.04.2025), ka verifikuar më datë 31.03.2025 pas njoftimit të bërë, dëmet që kishte pësuar banesa duke mbajtur proçes-verbalin përkatës të datës 31.03.2025. Pas plotësimit të dokumentacionit, është vijuar me përcjelljen e dokumentacionit komisionit të vlerësimit të dëmeve ngritur në Bashkinë Elbasan me Urdhër nr. 64 date 22.01.2025 "Per ngritjen e komisionit per vleresimin e demeve te shkaktuara ne objekte banimi nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi te tjera" për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga ekspertët e këtij komisioni. Ky komision, ka përgatitur preventivin mbi vlerën e dëmeve të objektit nga ana ndërtimore (sipas kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin përkatës ose sipas çmimeve në fuqi, sipas zërave të punimeve të ndërtimit, miratuar nga Këshilli i Ministrave për Entin Kombëtar të Banesave) dhe preventivin me vlerën e pajisjeve dhe orendive të dëmtuara (mbështetur në çmimet mesatare aktuale të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve) nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve ndërtimore në banesën e **Z. Vangjel Taqi Prifti,** është në masën **72,475 leke (shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë ) lekë.**
- Vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi e **Z. Vangjel Taqi Prifti,** është në masen **68,500 (gjashtëdhjetë e tetë mijë e peseqind) lekë.**

Në bazë të VKM-së cituar më sipër nr. 329 datë 16.05.2012 vlera e dëmeve në banesën e përcaktuar nga komisioni i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë merret nga pronari në masën prej 50% të shumës së nxjerrë. Pra në këtë rast **72,475 [1] x 50% = 36,237 lekë.**

Kësaj shume i shtojmë edhe vlerën prej **68,500** (**(gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind**) lekë që është vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi.

Në përfundim nga komisioni i vlerësimit të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së **Z. Vangjel Taqi Prifti** i takojnë **36,237 + 68,500 = 104,737** (njëqind e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë) lekë.

***Duke Ju falenderuar,***

| | | |
|---|---|---|
| **Konceptoi:** | Specialist | I. Hoxholli |
| **Miratoi:** | Drejtori MC | N. Sinani |
| **Konfirmoi:** | Dr. PPMCMBPK | Sh. Çullhaj |

**KRYETARI**
**Gledian Llatja**

**Me Urdhër e Porosi**
**ZV/KRYETARI**
**Asim Sula**

REPUBLIKA E SHQIPERISË - BASHKIA ELBASAN -

[1] Vlera e dëmeve në banesë

**Adresa:** *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**
*Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

Nr. ______ Prot. Elbasan më, ___.____.2025

**PROJEKT VENDIM**

**Nr.________Datë______.___.2025**

**Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Vangjel Taqi Prifti banor në lagjen "Visarjon Xhuvani", nr. 4 dhe dhënien e kompensimit nga ana e Bashkisë Elbasan**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; VKM nr. 329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 64 datë 30.05.2025 "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2025" si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile;

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI**

1. Miratimin e vlerës financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga djegia e banesës së Z. **Vangjel Taqi Prifti,** në bazë të dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar, e cila është ne **104,737** (njëqind e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë) lekë.

2. Kjo vlerë është rezultat i 50% të vlerës së preventivit të dëmeve ndërtimor në banesë të hartuar nga ekspertët duke shtuar më pas vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi d.m.th. **72,475 [1] x 50% = 36,237 + 68,500 [2] = 104,737 lekë.**

3. Burimi i financimit do të jetë Fondi i Mbrojtjes Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2025, i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 64

[1] Vlera e dëmeve në banesë
[2] Vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi

datë 30.05.2025 “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2025”.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave (Drejtoria e Mbrojtjes Civile).

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

**SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Sokol Sinani**

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Lutfi Lala**

| | | |
|---|---|---|
| **Konceptoi:** | Specialist | I. Hoxholli |
| **Pranoi:** | Drejtori MC | N. Sinani |
| **Miratoi:** | Dr. PPMCMBPK | Sh. Çullhaj |

Dr. Buxhet Financë A. Merkja
Dr. Juridike A. Hoxha

**Konfirmoi:** Zv/Kryetari A.Sula

(9)

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES CIVILE, MJEDISIT, BUJQËSISË, PYJEVE DHE KULLOTAVE**
**DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE**

Nr. 3130 Prot. Elbasan më 23/06 2025

## RELACION

**Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Kujtim Hasan Sulejmani banor në lagjen "11 Nëntori", nr. 5 dhe dhënien e kompensimit nga ana e Bashkisë Elbasan**

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Mbrojtjes Civile,

Në zbatim të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile" dhe të VKM nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", sektori përkatës pas marrjes së njoftimit verbalisht si edhe me shkresë zyrtare 132 prot. datë 20.01.2025 për djegien e banesës së **Z. Kujtim Hasan Sulejmani**, banor në lagjen "11 Nëntori", nr. 5 ( kërkesë e kryer nga znj. Odeta Sulejmani) në datë 17.01.2025 (konfirmuar edhe nga Vërtetimi i SHMZSH nr. 02 datë 21.01.2025), ka verifikuar më datë 23.01.2025 pas njoftimit të bërë, dëmet që kishte pësuar banesa duke mbajtur proçes-verbalin përkatës të datës 23.01.2025. Pas plotësimit të dokumentacionit, është vijuar me përcjelljen e dokumentacionit komisionit të vlerësimit të dëmeve ngritur në Bashkinë Elbasan me Urdhër nr. 64 date 22.01.2025 "Per ngritjen e komisionit per vleresimin e demeve te shkaktuara ne objekte banimi nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi te tjera" për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga ekspertët e këtij komisioni. Ky komision, ka përgatitur preventivin mbi vlerën e dëmeve të objektit nga ana ndërtimore (sipas kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin përkatës ose sipas çmimeve në fuqi, sipas zërave të punimeve të ndërtimit, miratuar nga Këshilli i Ministrave për Entin Kombëtar të Banesave) dhe preventivin me vlerën e pajisjeve dhe orendive të dëmtuara (mbështetur në çmimet mesatare aktuale të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve) nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve ndërtimore në banesën e **Z. Kujtim Hasan Sulejmani,** është në masën **332,600 leke (treqind e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind) lekë.**
- Vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi e **Z. Kujtim Hasan Sulejmani,** është në masen **402,000 (katërqind e dy mijë) lekë.**

Në bazë të VKM-së cituar më sipër nr. 329 datë 16.05.2012 vlera e dëmeve në banesën e përcaktuar nga komisioni i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë merret nga pronari në masën prej 50% të shumës së nxjerrë. Pra në këtë rast **332,600 [1] x 50% = 166,300 lekë.**

Kësaj shume i shtojmë edhe vlerën prej **402,000 (katërqind e dy mijë)** lekë që është vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi.

Në përfundim nga komisioni i vlerësimit të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së **Z. Kujtim Hasan Sulejmani** i takojnë **166,300 + 402,000 = 568,300** (pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e treqind) lekë.

***Duke Ju falenderuar,***

| | | |
|---|---|---|
| **Konceptoi:** | Specialist | I. Hoxholli |
| **Miratoi:** | Drejtori MC | N. Sinani |
| **Konfirmoi:** | Dr. PPMCMBPK | Sh. Çullhaj |

**KRYETARI**
**Gledian Llatja**

**Me Urdhër e Porosi**
**ZV/KRYETARI**
**Asim Sula**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

[1] Vlera e dëmeve në banesë

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**
*Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

Nr. ______ Prot. Elbasan më, ___.____.2025

**PROJEKT VENDIM**

**Nr._______Datë_____.___.2025**

**Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Kujtim Hasan Sulejmani banor në lagjen "11 Nëntori", nr. 5 dhe dhënien e kompensimit nga ana e Bashkisë Elbasan**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; VKM nr. 329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 64 datë 30.05.2025 "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2025" si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile;

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI**

1. Miratimin e vlerës financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga djegia e banesës së **Z. Kujtim Hasan Sulejmani,** në bazë të dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar, e cila është ne **568,300** (pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e treqind) lekë.

2. Kjo vlerë është rezultat i 50% të vlerës së preventivit të dëmeve ndërtimor në banesë të hartuar nga ekspertët duke shtuar më pas vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi d.m.th. **332,600 [1] x 50% = 166,300 + 402,000 [2] = 568,300 lekë.**

3. Burimi i financimit do të jetë Fondi i Mbrojtjes Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2025, i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 64 datë 30.05.2025 "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2025".

---

[1] Vlera e dëmeve në banesë
[2] Vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave (Drejtoria e Mbrojtjes Civile).

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

| SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK | KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK |
|---|---|
| **Sokol Sinani** | **Lutfi Lala** |

| | | |
|---|---|---|
| **Konceptoi:** | Specialist | I. Hoxholli |
| **Pranoi:** | Drejtori MC | N. Sinani |
| **Miratoi:** | Dr. PPMCMBPK | Sh. Çullhaj |
| | Dr. Buxhet Financë | A. Merkja |
| | Dr. Juridike | A. Hoxha |
| **Konfirmoi:** | Zv/Kryetari | A.Sula |

(10)

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES CIVILE, MJEDISIT, BUJQËSISË, PYJEVE DHE KULLOTAVE**
**DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE**

Nr. 3131 Prot. Elbasan më, 23. 06 .2025

**RELACION**

**Mbi shpërndarjen e fondit financiar të mbrojtjes civile të vitit 2025 për familjet e dëmtuara nga fatkeqësi natyrore dhe dhënien e ndihmës financiare nga ana e Bashkisë Elbasan**

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Mbrojtjes Civile,

Në mbështetje të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" si edhe në VKM-së nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerëzore" duam të paraqesim në mbledhjen e këtij komisioni shpërndarjen e fondit prej **5,349,304 lekë** i cili me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 64 datë 30.05.2025 "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2025" është përcaktuar për kompensime të familjeve, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore (tërmet dhe rrëshqitje).

Katërmbëdhjetë familjet kanë për të marrë edhe pjesën e fundit të kompensimit total të tyre dhe përmbyllin detyrimin që ka bashkia për të ndihmuar këto familje dhe për të zbatuar vendimet e Këshillit Bashkiak Elbasan që ka dhënë për çdo banesë të dëmtuar.

Sa më sipër, lutemi për të patur parasysh shpërndarjen e fondit ndërmjet këtyre familjeve, listën e të cilëve do ta gjeni bashkëngjitur.

***Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,***

| | | |
|---|---|---|
| **Konceptoi:** | Specialist | I. Hoxholli |
| **Miratoi:** | Drejtori MC | N. Sinani |
| **Konfirmoi:** | Drejtori PPMCMBPK | Sh. Çullhaj |

**KRYETARI**
**Gledian Llatja**

**Me Urdhër e Porosi**
**ZV/KRYETARI**
**Asim Sula**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

*Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

Nr. ______ Prot. Elbasan më, ___.____.2025

**PROJEKT VENDIM**

**Nr.______Datë_____.___.2025**

**Mbi shpërndarjen e fondit financiar të mbrojtjes civile të vitit 2025 për familjet e dëmtuara nga fatkeqësi natyrore dhe dhënien e ndihmës financiare nga ana e Bashkisë Elbasan**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; VKM nr. 329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 64 datë 30.05.2025 "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2025" si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile;

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI**

1. Miratimin e fondit financiar të kompensimit prej **5,349,304 lekë** për 14 (katërmbëdhjetë) familje sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Burimi i financimit do të jetë Fondi i Mbrojtjes Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2025, i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 64 datë 30.05.2025 "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2025".
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave (Drejtoria e Mbrojtjes Civile).

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

**SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK** **KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Sokol Sinani** **Lutfi Lala**

**Konceptoi:** Specialist I. Hoxholli
**Pranoi:** Drejtori MC N. Sinani
**Miratoi:** Dr. PPMCMBPK Sh. Çullhaj

Dr. Buxhet Financë A. Merkja
Dr. Juridike A. Hoxha

**Konfirmoi:** Zv/Kryetari A.Sula

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES CIVILE, MJEDISIT, BUJQËSISË, PYJEVE DHE KULLOTAVE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr.3174 Prot.                                                                 Elbasan më, 24.06.2025

**RELACION**

**Për ndryshimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak Elbasan nr. 64 datë 30.05.2025 të "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2025"**

*Të nderuar anëtarë të Komisionit të Mbrojtjes Civile,*

Në zbatim të nenit 65 të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile" Këshilli i Ministrave ka miratuar një vendim në Korrik të 2021 mbi ndarjen e fondit të Mbrojtjes Civile.
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 414 datë 8.7.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kritereve për përdorimin dhe shpërndarjen e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile" specifikon qartësisht kriteret e ndarjes së fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile si edhe përdorimit të tij në bazë të disa kritereve të vendosura.
Procedura e cila duhet të plotësohet është e tillë që pasi Drejtoria e Mbrojtjes Civile planifikon mënyrën e përdorimit të këtij fondi sipas disa indikatorëve të cilët vendosen në bazë të prioriteteve për mbrojtjen civile në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Buxhet dhe Finacës, duhet ta miratojnë në Këshillin Bashkiak.
Ministria e Mbrojtjes nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile ka dërguar me shkresë zyrtare akordimin e fondit të kushtëzuar për vitin 2025 për Bashkinë Elbasan i cili është **28,405,901.72 lekë.**
Shpërndarja e fondit është bërë sipas prioritizimit të përcaktuar në VKM nr. 414 datë 8.7.2021 dhe problematikave të konstatuara nga Emergjencat Civile për të cilat duhen marrë masa parandaluese, mbrojtëse, lehtësuese dhe rehabilituese në objektet që përbëjnë kërcënim serioz për jetën e njerëzve, pronat e tyre dhe mjedisin. Pjesa më e madhe e këtij fondi është parashikuar të shkojë për kompensimin e familjeve të dëmtuara fatkeqësitë respektive të ndodhura. Pjesa tjetër e fondeve është e ndarë sipas zërave të mëposhtme dhe konsiston në:

1. Ndërtim i këmbëve të urës dhe speronave të urës tip beli në fshatin Papër Sollak (lgj. "Matrej" ), Njesia Administrative Paper;

Ky investim është i domosdoshëm dhe emergjent për të siguruar kalueshmërinë nga njëra anë e përroit në anën tjetër, të garantojë sigurinë e lëvizjes së banorëve dhe të nxënësve (rreth 45

banorëve), pasi aktualisht ata kalojnë mes përroit të Gorres (devijim i përroit të Paprit) duke rrezikuar jetën e tyre në kohë me reshje shiu.

2. Ndërtim i këmbëve të urës dhe speronave të urës tip beli në fshatin Muriqan ,Njësia Administrative Gjergjan;

Përsa i përket, ndërtimit të kësaj urë është e domosdoshme pasi aktualisht banorët kalojnë në një urë këmbësore e cila paraqet rrezik për qarkullimin për shkak të shirave pasi mbulohet nga uji dhe bëhet e pakalueshme. Për të eleminuar rrezikshmërinë e urës ekzistuese dhe për të bërë të mundur lëvizshmërinë e banorëve (40 banorëve) këmbësorë dhe me mjetë është i domosdoshëm ndërtimi i urës tip beli me hapësirë drite 10 m, në mënyrë që të zgjidhë problematikën e këtyrë banorëve. Kjo urë do të shërbejë për lidhjen e lagjes "Çepalli" me rrugën e asfaluar Muriqan – Elbasan, si edhe për të bërë të mundur kalimin e mjeteve bujqësore për të kryer shërbimet në parcelat bujqësore që ata kanë në pronësi.

3. Ndërtim shkalle metalike në pallatin nr. 42 , Rruga "Serafin Jorgaqi", Lagjja Shenkoll. Shkalla ekzistuese është jashtë funksionit dhe paraqet rrezik serioz për banorët për përdorim të përditshëm. Kjo shkallë është e ndërtuar në vitet '50 me material druri të cilat janë plotësht të amortizuara duke rrezikuar jetën e banorëve të pallatit.

4. Detyrime të prapambetura nga investimet e vitit 2024 për objektet financuara dhe miratuar me VKB-të nr. 26 dt. 28.03.2024 dhe nr. 101 dt. 30.09.2024
5. Blerje pajisje ndihmëse (pompa shpine, helmeta, fryrwse gjethesh) për fikjen e zjarrit + helmeta për MZSH -në
6. Blerje shtylla me h= 9m + kabell (4*94) mm per furnizimin me energji elektrike te pompes se hidranteve Kraste;
7. Shpenzime për mbajtjen në gatishmëri të kalueshmerisë së mjeteve zjarrfikes ne rruge pyjore (blerje karburanti);

Përsa i përket zërave të shpenzimeve është e nevojshme të parashikohen pasi disa zona pyjore sikurse është rruga që kalon në mes të pyllit të Bukanikut dhe malit të Zavalinës nuk janë të aksesueshme nga mjetet zjarrëfikëse. Po kështu edhe pylli i Krastës dhe kurora e Elbasanit e mbjellë me ullinj shekullorë nuk mund të arrihet nga mjetet zjarrëfikës. Për këtë arsye është e nevojshme të parashikohet ky shpenzim për blerje karburanti për mjetet e ASHP-së që do të punojnë për hapjen e këtyre rrugëve.

8. Shpenzime operative për përballimin e ngjarjeve dhe situatave të emergjencave civile.

Këto fonde përdoren për mbulimin e kostove të menjëhershme që lidhen me ndërhyrjet në raste emergjente, si zjarre, përmbytje apo fatkeqësi të tjera natyrore. Shpenzimet përfshijnë furnizimet e nevojshme për forcat ndihmëse, transportin dhe shërbimet teknike që mundësojnë reagimin efikas dhe të koordinuar të strukturave të mbrojtjes civile në mbrojtje të jetës, shëndetit dhe pasurisë së qytetarëve.

Në muajin Maj, Drejtoria e Mbrojtjes Civile bëri ndarjen e fondit të ardhur nga Ministria e Mbrojtjes për vitin 2025, por ky fond duhet specifikuar në objekte të përcaktuara.

Sa më sipër, lutemi për të patur parasysh këto shpërndarje të përdorimit të fondit të mbrojtjes civile për vitin 2025 të cilën do ta keni bashkëngjitur këtij relacioni me zërat dhe shumat përkatëse.

Duke Ju falenderuar,

**Konceptoi:** Specialist I. Hoxholli
**Miratoi:** Drejtori MC N. Sinani
**Konfirmoi:** Dr. PPMCMBPK Sh. Çullhaj

**KRYETARI**
**Gledian Llatja**

**Me Urdhër e Porosi**
**ZV/KRYETARI**
**Asim Sula**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK
*Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

Nr. ______ Prot. Elbasan më, ___.____.2025

**PROJEKT VENDIM**

**Nr.______Datë_____.___.2025**

**Për ndryshimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak Elbasan nr. 64 datë 30.05.2025 të "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2025"**

Në mbështetje të: ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 65 të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile", VKM nr. 414 datë 8.7.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kritereve për përdorimin dhe shpërndarjen e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile"; si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile;

**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D O S I**

1. Miratimin e përdorimit të fondit të Mbrojtjes Civile prej **28,405,901** lekë sipas shpërndarjes në objektet e mëposhtme:

| **Nr** | **Emertimi i objektit** | **Njesia** | **Sasia** |
|---|---|---|---|
| **1** | Kompesime të demeve te shkaktuara nga fatkeqësite natyrore | lek | 14,600,000 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 2 | Ndertim i kembeve te ures dhe speronave te ures tip beli ne fshatin Papër Sollak (lgj. "Matrej" ), Njesia Administrative Paper | lek | 4,995,000 |
| 2.1 | Supervizim | lek | 129,740 |
| 2.2 | Kolaudim | lek | 19,461 |
| 3 | Ndertim i kembeve te ures dhe speronave te ures tip beli ne fshatin Muriqan ,Njesia Administrative Gjergjan. | lek | 4,995,000 |
| 3.1 | Supervizim | lek | 129,740 |
| 3.2 | Kolaudim | lek | 19,461 |
| 4 | Ndertim shkalle metalike ne pallatin nr.42 ,Rruga Serafin Jorgaqi, Lagjja Shenkoll. | lek | 698,866 |
| 4.1 | Supervizim | lek | 12,698 |
| 4.2 | Kolaudim | lek | 1,229 |
| 5 | Detyrime te prapambetura nga investimet e vitit 2024 per objektet financuara dhe miratuar me VKB-të nr. 26 dt. 28.03.2024 dhe nr. 101 dt. 30.09.2024 | lek | 245,540 |
| 6 | Blerje pajisje ndihmese per fikjen e zjarrit + helmeta per MZSH -ne | lek | 1,000,000 |
| 7 | Blerje shtylla me h= 9m + kabell (4*94) mm per furnizimin me energji elektrike te pompes se hidranteve Kraste | lek | 702,000 |
| 8 | Shpenzime per mbajtjen ne gadishmeri te kalueshmerise se mjeteve zjarrfikes ne rruge pyjore (blerje karburanti) | lek | 707,166 |
| 9 | Shpenzime operative per perballimin e ngjarjeve dhe situatave te emergjences civile. | lek | 150,000 |
| | **TOTALI** | | **28,405,901** |

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave (Drejtoria e Mbrojtjes Civile).

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

| SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK | KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK |
|---|---|
| **Sokol Sinani** | **Lutfi Lala** |

| | | |
|---|---|---|
| **<u>Konceptoi</u>:** | Specialist | I. Hoxholli |
| **<u>Pranoi:</u>** | Drejtori MC | N. Sinani |
| **<u>Miratoi</u>:** | Dr. PPMCMBPK | Sh. Çullhaj |
| | Dr. Buxhet Financë | A. Merkja |
| | Dr. Juridike | A. Hoxha |
| **<u>Konfirmoi</u>:** | Zv/Kryetari | A.Sula |

Miratuar me ________vota
Vota Pro______
Vota Kunder_______
Vota Abstenim__________
Zbardhur me datë ____/____ 2025

(12)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr.3227 Prot. Elbasan më 26.06.2025

**RELACION**

**Për miratim në parim të dhënies së pëlqimit për lejimin e shtrirjes së rrjetit inxhinierik të furnizimit me ujë kurativ termal në prona shtetërore (rrugë, pyll, përrua etj) në Njësië Administrative Tregan**

**KËSHILLIT BASHKIAK**

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 22 pika 1, neni 64/a; ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" të ndryshuar"; ligjit nr. 10448 datë 14.07.2011 "Për mjedisin" të ndryshuar ; ligjit nr. 57/2020 datë 30.04.2020 "Për pyjet"; ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor" të ndryshuar; të VKM nr 550 datë 15.07.2020, si edhe të kërkesave të subjekteve private përkatësisht "Hysen Miza", "Mirela Çekrezi", "Neki Boçi dhe Beqir Boçi", "Dallandyshe Çela", të cilat kanë ardhur me shkresë përcjellëse nga Njësia Administrative Tregan, që do të aplikojnë për pajisje me leje përdorimi të ujrave hidrotermal për qëllime kurative dhe për rinovimin e lejes ekzistuese të lejes për përdorim uji për qëllime higjeno-sanitare, pranë institucionit përgjegjës që është Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore. Sipas VKM-së 550 datë 15.07.2020, ky organ pra AMBU-ja kërkon që subjektet aplikuese në dokumentacionin e përcaktuar duhet të dorëzojnë edhe dokumente pronësie të pasurisë ose marrëveshje me pronarët e pronave ku kalon rrjeti inxhinierik (tubacionet e ujit) i ujësjellësave që furnizojnë qendrat kurative të bizneseve private me ujë termal për qëllime kurative dhe higjenike, të cilat janë të vendosura në prona shtetërore. Në rastin konkret, subjektet e sipërcutuara do të lidhin marrëveshje me Bashkinë Elbasan për lejimin e shtrirjes së rrjetit inxhinierik të furnizimit me ujë kurativ termal në pronat përkatëse shtetërore. Meqenëse shfrytëzimi i këtyre pronave shtetërore ka nevojë të marrë miratimin e Këshillit Bashkiak Elbasan për tubacionet e ujësjellsave do të kalojnë në pronat shtetërore të bashkisë është e domosdoshme që ky organ të autorizojë Bashkinë Elbasan të lidhë

marrëveshje për lejimin e shtrirjes se rrjetit inxhinjerik te furnizimit me uje kurativo termal ne prona shtetërore ( rruge, pyll, perrua etjer ) për këtë qëllim. Në rast se dëmtimi, subjektet do ta rikthejnë në gjendjen e mëparshme dhe per shtrirjen e rrjetit inxhinjerik ne pronen shteterore do të paguajnë tarifat vendore të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak Elbasan për vitin 2025. Me miratimin e këtij vendimi subjekteve i lind e drejta të fillojnë procedurat per aplikim per tu pajisur me leje perdorimi te ujit termal si dhe te rinovimit të lejes ekzistuese per perdorim te ujit higjeno sarnitar nga organi përgjegjës për dhënien e tyre që është Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

Sa më sipër, i kërkojmë Këshillit Bashkiak të votojë këtë projekt-vendim

Duke Ju falenderuar,

**Konceptoi:**

Specialisti D.M : B.Brahja

P/Sektorit D.M : I.Kaculi

Administatori Nj.Adm.Tregan M.Rexhepi

**Pranoi:**

Drejtori D.M : T.Sinanaj

**Konfirmoi:**

Drejtori D.P.MCMBPK : Sh.Cullhaj

**KRYETARI**
**Gledian Llatja**

**ME URDHËR E POROSI**

**ZV/KRYETARI**
**Asim Sula**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK
*Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

Nr. ______ Prot. Elbasan më, ___.____.2025

**PROJEKT VENDIM**

**Nr.________Datë:______.___.2025**

**Për miratim në parim të dhënies së pëlqimit për lejimin e shtrirjes se rrjetit inxhinjerik te ujesjellesit te ujrave kurativ termal dhe ujrave higjeno sarnitar ne prona shtetërore ( rruge, pyll, perrua etj. ) , në Njësinë Administrative Tregan .**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 22 pika 1, neni 64/a; ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" të ndryshuar"; ligjit nr. 10448 datë 14.07.2011 "Për mjedisin" të ndryshuar ; ligjit nr. 57/2020 datë 30.04.2020 "Për pyjet"; ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor" të ndryshuar; të VKM nr 550 datë 15.07.2020, si edhe pasi shqyrtoi kërkesat e subjekteve private së bashku me relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Monitorimit:

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI :**

1. Të miratojë në parim dhënien e pëlqimit për lejimin e shtrirjes se rrjetit inxhinjerik ne prona shtetërore ( rruge, pyll, perrua etj. ), per furnizimin me uje termal ose uje higjeno - sanitar në funksion të subjekteve që ushtrojne aktivitet ne qendrat e tyre kurative termale me vendndodhje në Njësinë Administrative Tregan .

2. Lista e pronave qe subjekti do të lidhe marrëveshje me Bashkinë Elbasan do të jetë sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr | Subjekti kërkues | Nipt i subjektit | Rinovim Leje | Leje e perdorimit te ujit | Lloji i ujit | Zona Kadastrale | Nr.e pasurisë shtetërore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Hysen Miza | M12806204A | Rinovim | | Higjeno Sarnitar | 3633 1407 | 132/52; 132/36; 141/8;145/7; 140/1/3;145/9 145/8;140/1; 158/2. |
| 2 | Mirela Cekrezi | M23204201U | | Leje e shfrytezimit te ujit | Hidrotermal | 1407 | 145; 141;174; 282;262:14 |
| 3 | Neki Boci &Beqir Boci | L82614202B | | Leje e shfrytezimit te ujit | Hidrotermal | 3633 | 140/1/1;274;141/1;141/8; 140/1/3; 140/1/2 |
| 4 | Dallandyshe Cela | K93405202V | | Leje e shfrytezimit te ujit | Hidrotermal | 3633 | 41/1;279/1;140/1/3; 138/3;278 |

3. Subjekti përfitues i lejes nga AMBU-ja do të lidhe kontratë e do të tarifohet sipas VKB-së nr. 139 datë 26.12.2024 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan për vitin 2025".
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Pronave Publike, Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Tregjeve , Drejtoria e Projektimit Urban , Drejtoria e Pergjithshme e Mbrojtjes Civile , Mjedisit ,Bujqesise , Pyjeve dhe Kullotave , Drejtoria Juridike dhe Informacionit, dhe Drejtoria e Monitorimit.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**
**Sokol Sinani**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**
**Lutfi Lala**

| | | |
|---|---|---|
| **Konceptoi**: | Spec. D. M | B.Brahja |
| | Përgj sekt. | I. Kaçuli |
| Administatori | Nj.Adm.Tregan | M. Rexhepi |
| **Pranoi:** | Dr. Monit . | T. Sinanaj |
| **Miratoi:** | Dr. PPMCMBPK | Sh. Çullhaj |
| Dr. Juridike | A. Hoxha | |
| **Konfirmoi**: | Zv/Kryetari | A.Sula |

# PLANVENDOSJA E SKEMES
## MBI HARTE KADASTRALE
PER PERSON FIZIK MIRELA ÇEKREZI NIPT M23204201U
ME ADMINISTRATORE Znj.MIRELA ÇEKREZI
FSHATI "KYCYK ",NJESIA ADMINISTRATIVE TREGAN
BASHKIA ELBASAN

SH 1:1000




BURIMI I UJRAVE TERMALE
TE DHENAT TEKNIKE:

"A" BURIMI KALIT
GRUPI 7 BURIMI NR 18

Q=0.5 l/s

"A" BURIMI UJI TERMAL
SISTEMI KORDINATIV
KRGJSH

| (x) VERI "N" | (y) LINDJA " E" | LARTESI (Z) |
|---|---|---|
| 4542889.14 | 507361.32 | 218.0 m |

"B" PIKA SHFRYTEZIMIT
SISTEMI KORDINATIV
KRGJSH

| (x) VERI "N" | (y) LINDJA " E" | LARTESI (Z) |
|---|---|---|
| 4542510.23 | 506874.55 | 207.0 m |

LEGJENDE:
Ⓐ BURIMI
Ⓑ OBJEKT PIKA SHFRYTEZIMIT

ZONA KADASTRALE 1407
PASURITE QE PREKEN:
145; 141; 174; 282; 262/14;

TUB HDPEØ 32 mm DERGMI UJI TERMAL

| | | |
|---|---|---|
| REPUBLIKA E SHQIPERISE | EMERTESA OBJEKTIT: PROJEKTIN HIDROTEKNIK I MARRJES TE UJIT TERMAL PER PERSON FIZIK MIRELA ÇEKREZI NIPT M23204201U | Nr.fletes H-06 |
| | EMERTESA FLETES: PLANVENDOSJE MBI HARTE KADASTRALE | SH - 1:1000 |
